

PËRAFRIMI AKTEVE NDËR VITE

Pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë, një hap i rëndësishëm është përqasja e plotë e legjislacionit në fushën e konkurrencës me atë të Acquis së BE-së. Zbatimi i zotimeve të marra në kuadër të Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (PKZMSA) dhe përmbushja e detyrimeve që rrjedhin për përafrimin e legjislacionit, mbetet prioritet në fushën e konkurrencës.

AK ka hartuar cdo vit Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) i cili është 3 vjecar dhe ka zbatuar këtë plan.

Në 5 vitet e fundit aktet e përafruara sipas planeve 3 vjecare përkatëse kanë qënë si më poshtë:

2020

Në zbatim të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2020-2022, AK ka përmbushur 100% procesin e përafrimit të legjislacionit me direktivat europiane në fushën e konkurrencës, konkretisht:

1. KK, me vendimin nr. 697, datë 30.06.2020, ka miratuar udhëzuesin “Për fuqizimin e Autoritetit të Konkurrencës për të qënë sa më i efektshëm në zbatueshmërinë e ligjit nr. 9121/2003 dhe për të siguruar funksionimin e duhur të tregut”. Ky Udhëzues ka përfaruar Direktivën (EU) 2019/1 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 11 dhjetor 2018 “Për fuqizimin e Autoriteteve të Konkurrencës të Shteteve Anëtare për të qënë më efektiv dhe të sigurojnë funksionimin e duhur të tregut të brendshëm” (32019L0001).
2. KK, me vendimin nr. 683, datë 18.03.2020, ka miratuar udhëzuesin “Mbi konkurrencën në tregjet e rrjeteve dhe shërbimeve për komunikimet elektronike”. Ky Udhëzues ka përfaruar Direktivën e Komisionit 2002/77/EC të datës 16 shtator 2002 “Mbi konkurrencën në tregjet e rrjeteve dhe shërbimeve për komunikimet elektronike” (320032L0077).

Përveç këtyre dy akteve të parashikuara në PKIE 2020-2022, me synim plotësimin e kuadrit ligjor dytësor në fushën e konkurrencës, janë përafruar dhe janë miratuar edhe dy akte nënligjore të tjera:

1. KK, me vendimin nr. 694, datë 15.05.2020, ka miratuar udhëzuesin “Mbi konfidencialitetin dhe aksesin në dosje”. Ky udhëzues ka përfaruar rregulloren e Këshillit (EC) nr. 1/2003 të datës 16 dhjetor 2002 “Për implementimin e rregullave të konkurrencës të parashikuar në nenet 81 dhe 82 të TFEU”, si dhe Njoftimin e Komisionit “Mbi rregullat e aksesit në dosjen e Komisionit për rastet sipas neneve 81 dhe 82 të TFEU, nenet 53, 54 dhe 57 të marrëveshjes së EEA dhe Rregullores së Këshillit (EC) nr. 139/2004”;
2. KK, me vendimin nr. 678, datë 13.02.2020, ka miratuar udhëzuesin “Për praktikat më të mira për kryerjen e procedurave në lidhje me zbatimin e neneve 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003”. Ky udhëzues ka përfaruar Njoftimin e Komisionit “Mbi praktikat më të mira për sjelljet sipas neneve 101 dhe 102 të TFEU / (2011/C 308/06)”.

2021

Gjatë vitit 2021, AK ka hartuar Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2022-2024, i cili është dokumenti bazë për përcaktimin e prioritetëve, planifikimin, koordinimin dhe monitorimin e përmbushjes së detyrimeve në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. AK ka përgatitur dhe integruar në këtë plan kombëtar Kapitullin 8 “Politika e Konkurrencës”, duke parashikuar nismat ligjore afatshkurtra dhe afatmesme në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit me atë të BE-së. Në zbatim të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2021-2023, AK, brenda afateve të parashikuara, ka përmbushur 100% procesin e përafrimit të legjislacionit me direktivat evropiane në fushën e konkurrencës, konkretisht:

1. KK, me vendimin nr. 807, datë 10.06.2021, ka miratuar Udhëzimin “Mbi praktikat më të mira në rastet e zbatimit të procedurave të kontrollit të përqendrimeve”. Ky udhëzues ka përafruar Udhëzimin e BE “Mbi praktikat më të mira në rastet e zbatimit të procedurave të kontrollit të përqendrimeve”;
2. KK, me vendimin nr. 781, datë 12.03.2021, ka miratuar Udhëzimin “Mbi praktikat më të mira për dorëzimin e provave me karakter ekonomik dhe mbledhjen e të dhënave, në rastet që kanë të bëjnë me zbatimin e nenit 4 dhe nenit 9 të ligjit nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si dhe në rastet e përqendrimeve”. Ky udhëzues ka përafruar Udhëzimin e BE “Praktikat më të mira për dorëzimin e provave me karakter ekonomik dhe mbledhjen e të dhënave, në rastet që kanë të bëjnë me zbatimin e neneve 101 dhe 102 të Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian (TFEU) dhe në rastet e përqendrimeve”.

2022

Gjatë vitit 2022, AK ka hartuar Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2023 - 2025, i cili është dokumenti bazë për përcaktimin e prioritetëve, planifikimin, koordinimin dhe monitorimin e përmbushjes së detyrimeve në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. AK ka përgatitur dhe integruar në këtë plan kombëtar kapitullin 8 “Politika e konkurrencës”, duke parashikuar nismat ligjore afatshkurtra dhe afatmesme në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit me atë të BE-së.

Në përputhje me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2021 - 2023, Autoriteti i Konkurrencës ka përmbushur 100% këtë plan, duke miratuar brenda afateve kohore të përcaktuara, nismat ligjore të parashikuara, në përputhje të plotë me legjislacionin evropian në fushën e konkurrencës.

1. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 890, datë 10.06.2022 miratoi “Udhëzim mbi kufizimet e konkurrencës “sipas objektivit” për qëllime të përcaktimit të marrëveshjeve me rëndësi të vogël”

2023

Në përputhje me Planin Kombëtare për Integrimin Evropian 2023 - 2025, Autoriteti i Konkurrencës ka përmbushur 100% këtë plan, duke miratuar brenda afateve kohore të përcaktuara, aktet nënligjore të parashikuara, në përputhje të plotë me legjislacionin evropian në fushën e konkurrencës.

1. KK, me vendimin nr. 990, datë 08.06.2023, ka miratuar Udhëzuesin "Mbi udhëzimet jozyrtare për sa i përket çështjeve të reja ose të pazgjidhura në lidhje me nenet 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" për raste individuale", në përputhje me Njoftimin e Komisionit mbi udhëzimet jozyrtare për sa i përket çështjeve të reja ose të pazgjidhura në lidhje me nenet 101 dhe 102 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian për raste individuale (letra udhëzuese) (C (2022) 6925 final).
2. KK, me vendimin nr. 1043, datë 29.12.2023, ka miratuar "Manuali i procedurave për sjelljet antikonkurruese", në përputhje me Manualin e Procedurave të sjelljeve anti-konkurruese (Dokument i Komisionit Evropian, Nëntor 2019).
3. KK, me vendimin nr. 1040 datë 22.12.2023, ka miratuar Udhëzuesin "Mbi praktikat më të mira për zbulimin e informacionit në bazat e të dhënave, gjatë procedurave hetimore dhe të kontrollit të përqendrimeve të parashikuara në ligjin nr. 9121, datë 28.07.2023 "Për mbrojtjen e konkurrencës", në përputhje me Praktikën më të mira për zbulimin e informacioneve në procedurat sipas neneve 101 dhe 102 të TFEU dhe sipas Rregullores së Përqendrimeve (2 Qershor 2015/Dokument i Komisionit Evropian).

2024

Në përputhje me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 - 2026, Autoriteti i Konkurrencës ka përmbushur 100% këtë plan, duke miratuar brenda afateve kohore të përcaktuara, aktet nënligjore të parashikuara, në përputhje të plotë me legjislacionin evropian në fushën e konkurrencës.

1. KK, me Vendimin nr. 1093, datë 11.07.2024, ka miratuar Udhëzimin "Mbi zbatimin e Ligjit nr. 9121/2003 "Mbi mbrojtjen e konkurrencës" për marrëveshjet kolektive në lidhje me kushtet e punës së të vetëpunësuarve", në përputhje me 'Njoftimin e Komisionit Evropian "Udhëzime mbi zbatimin e ligjit të konkurrencës së Bashkimit Evropian për marrëveshjet kolektive në lidhje me kushtet e punës së personave të vetëpunësuar të pavarur" (2022/C 374/02)'.
2. KK, me Vendimin nr. 1108, datë 16.09.2024, ka miratuar Udhëzimin "Për referimin e çështjeve në lidhje me përqendrimet", në përputhje me 'Njoftimin e Komisionit Evropian "Për Referimin e Çështjeve në lidhje me Përqendrimet (2005/C 56/02)'.

2025

Në përputhje me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 - 2026, Autoriteti i Konkurrencës ka përmbushur 100% këtë plan, duke miratuar brenda afateve kohore të përcaktuara, aktet nënligjore të parashikuara, në përputhje të plotë me legjislacionin evropian në fushën e konkurrencës.

1. KK, Me Vendimin nr. 1217, datë 26.09.2025, ka miratuar Rregulloren “Për përjashtimin e disa kategorive të marrëveshjeve të kërkimit dhe zhvillimit” në përputhje me ‘Rregulloren e Komisionit Evropian Nr. 1066/2023 “Mbi zbatimin e nenit 101/3 të Traktatit të Funksionimit të Bashkimit Evropian për disa kategori të marrëveshjeve të kërkimit dhe zhvillimit”.
2. KK, Me Vendimin nr. 1248, datë 19.12.2025, ka miratuar Rregulloren “Për përjashtimin e disa kategorive të marrëveshjeve të specializimit” në përputhje me ‘Rregulloren Nr. 1067/2023 e Komisionit Evropian “Mbi zbatimin e nenit 101(3) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian në kategori të caktuara të marrëveshjeve të specializimit”.
3. KK, Me Vendimin nr. 1249, datë 19.12.2025, ka miratuar Rregulloren “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara” në përputhje me ‘Rregulloren Nr. 720/2022 e 10 Majit 2022 mbi aplikimin e nenit 101(3) të Traktatit të Funksionimit të BE-së për disa kategori marrëveshjesh vertikale dhe praktikave të bashkërenduara, e cila zëvendëson rregulloren Nr. 330/2010, datë 20.04.2010.
4. KK, Me Vendimin nr. 1250, datë 19.12.2025, ka miratuar Udhëzimin “Mbi kufizimet vertikale” në përputhje me ‘Udhëzimin e Komisionit Evropian “Mbi kufizimet vertikale” (2022/C 248/01).

Për vitin 2026 janë planifikuar:

1. Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1419/2006, datë 25 shtator 2006, për shfuqizimin e Rregullores (KEE) nr. 4056/86, që përcaktonte rregulla të hollësishme për zbatimin e neneve 85 dhe 86 të Traktatit për transportin detar, si dhe për ndryshimin e Rregullores (KE) nr. 1/2003 në lidhje me shtrirjen e fushës së saj të zbatimit për të përfshirë kabotazhin dhe shërbimet ndërkombëtare tramp;
2. Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 411/2004, datë 26 shkurt 2004, për shfuqizimin e Rregullores (KEE) nr. 3975/87 dhe për ndryshimin e Rregulloreve (KEE) nr. 3976/87 dhe (KE) nr. 1/2003, në lidhje me transportin ajror ndërmjet Komunitetit dhe vendeve të treta;
3. Komunikim i Komisionit – Ndryshime në Njoftimin e Komisionit mbi imunitetin nga gjrobat dhe uljen e gjobave në rastet e karteleve;
4. Njoftimi i Komisionit i datës 18 dhjetor 1978, lidhur me vlerësimin e disa marrëveshjeve të nënkontraktimit në raport me nenin 85(1) të Traktatit;
5. Njoftimi i Komisionit mbi përkufizimin e tregut përkatës për qëllime të së drejtës së konkurrencës së Bashkimit Evropian (C/2024/1645);
6. Njoftim i Komisionit – Udhëzime plotësuese mbi kufizimet vertikale në marrëveshjet për shitjen dhe riparimin e mjeteve motorike dhe për shpërndarjen e pjesëve të këmbimit për mjetet motorike;
7. Komunikim i Komisionit mbi kuantifikimin e dëmit në paditë për dëmshpërblim të bazuara në shkeljet e neneve 101 ose 102 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian;

8. Njoftimi i Komisionit – Udhëzime mbi konceptin e ndikimit në tregti, të përfshirë në nenet 81 dhe 82 të Traktatit;
9. Direktiva (BE) 2019/1 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 11 dhjetor 2018, për fuqizimin e autoriteteve kombëtare të konkurrencës për një zbatim më efektiv dhe për garantimin e funksionimit të rregullt të tregut të brendshëm (Direktiva ECN+);
10. Njoftimi i Komisionit mbi trajtimin e thjeshtuar të disa përqendrimeve, sipas Rregullores së Këshillit (KE) nr. 139/2004 për kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve (2023/C 160/01);
11. Udhëzues mbi përgatitjen e versioneve publike të vendimeve të Komisionit, të miratuara në bazë të Rregullores për përqendrimet;
12. Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2023/914, datë 20 prill 2023, për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 139/2004 mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve dhe për shfuqizimin e Rregullores së Komisionit (KE) nr. 802/2004.